



UNIVERSITETI I PRIZRENIT

UNIVERSITY OF PRIZREN

„Ukshin Hoti“  
Rektorati

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrenia „UKSHIN HOTI“	
Pranuar me dt.	31/07/2015
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-289

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref. 01-\_\_\_\_\_ Prizren, më

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr. 04/l-037, si dhe dispozitat e nenit 47 paragrafi 1.3 të Statutit, Senati i UPZ-së në mbledhjen e mbajtur më datë 29.07.2015, mori vendim (nr. 01-283) për të:

Shpallë

## KONKURS

për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren

### I. FAKULTETI JURIDIK

1. **Një mësimpldhënës për lëndët:** E drejta civile; E drejta civile procedurale (E drejta e procedurës civile pjesa kontestimore).
2. **Një mësimpldhënës për lëndët:** E drejta romake dhe E drejta e detyrimeve.
3. **Një mësimpldhënës për lëndët:** E drejta e punës dhe Sigurimit social; E drejta financiare / Financat dhe e drejta financiare (E drejta tatimore), dhe E drejta e falimentimit.
4. **Një asistent** për grupin e lëndëve të së drejtës publike (Fillet e së drejtës; Historia e shtetit dhe së drejtës në përgjithësi dhe në veçanti shtetit shqiptar; E drejta romake).
5. **Një asistent** për grup lëndësh nga fusha e së drejtës ndërkombëtare (E drejta publike; E drejta evropiane; E drejta diplomatike dhe konsullore; E drejta penale ndërkombëtare; Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut; E drejta ndërkombëtare humanitare, dhe E drejta ndërkombëtare private).

### II. FAKULTETI EKONOMIK

1. **Një mësimpldhënës për lëndët:** Financat ndërkombëtare dhe Makroekonomi.
2. **Një mësimpldhënës për lëndët:** Ndërmarrësi dhe Bazat e menaxhimit.
3. **Një mësimpldhënës për lëndët:** Mikroekonomi dhe Bazat e financës
4. **Një mësimpldhënës për lëndët:** Gjuhës angleze I dhe II

5. **Një asistent** për grup lëndësh nga fusha ekonomike.

### III. FAKULTETI I EDUKIMIT

#### A. Në Programet mësimore në gjuhën Shqipe

1. **Një mësues** për lëndët: **Matematika I** (Prog. Fillor); **Matematika I** (Prog. Parafillor); **Matematika II** (Prog. Fillor); **Matematika II** (Prog. Parafillor); dhe **Metodika e mësimit të matematikës** (Prog. Fillor).
2. **Një mësues** për grup lëndësh pedagogjike.
3. **Një asistent** për lëndët: **Histori kombëtare** (Prog. Fillor); **Histori kombëtare** (Prog. Parafillor); **Bazat e shkencave shoqërore me metodologji** (Prog. Fillor); **Bazat e shkencave shoqërore me metodologji** (Prog. Parafillor); **Historia e arsimit kombëtar** (Prog. Fillor dhe Parafillor); dhe **Edukatë qytetare** (Prog. Fillor dhe Parafillor).

#### B. Në Programet mësimore në gjuhën Turke

1. **Një mësues** për grup lëndësh pedagogjike.
2. **Një mësues** për lëndët: **Bazat e shkencave natyrore me metodologji I** (Prog. Fillor dhe Parafillor); dhe **Bazat e shkencave natyrore me metodologji II** (Prog. Fillor dhe Parafillor).

#### C. Në Programet mësimore në gjuhën Boshnjake

1. **Një mësues** për lëndët: **Matematika I** (Prog. Fillor); **Matematika I** (Prog. Parafillor); **Matematika II** (Prog. Fillor); **Matematika II** (Prog. Parafillor); dhe **Metodika e mësimit të Matematikës** (Prog. Fillor).
2. **Një mësues** për grup lëndësh pedagogjike.
3. **Një mësues** për lëndët: **Gjuhë boshnjake I** (Prog. Fillor dhe Parafillor); dhe **Gjuhë boshnjake II** (Prog. Fillor dhe Parafillor).
4. **Një mësues** për lëndët: **Bazat e shkencave natyrore me metodologji I** (Prog. Fillor dhe Parafillor); dhe **Bazat e shkencave natyrore me metodologji II** (Prog. Fillor dhe Parafillor).

### IV. FAKULTETI I FILOLOGJISË

1. **Një mësues** për lëndët: **Hyrje në gjuhësi** (sem. I); **Morfologji I, II** (sem. III, IV); **Sintaksë I, II** (sem.V-VI, programi i Gjuhës shqipe) dhe **Gjuhë amtare I, II** (sem.II, programi i Gjuhës angleze).
2. **Një mësues** për lëndët: **Kulturë gjuhe** (sem. II); **Fonetikë** (sem. III); **Histori e gjuhës standarde** (sem. III); **Dialektologji** (sem.V), **Metodologji e gjuhës amtare** (sem.V), dhe **Filologji shqiptare** (sem. III, programi i Gjuhës shqipe).

3. **Një mësimdhënës për lëndët:** Gjuhë amtare I, II, III (sem. I, II, III, programi Gjuhës gjermane); Leksikologji (sem. II); Gjuhësi ballkanike (sem. IV), dhe Sociolinguistikë (sem. V).
4. **Një mësimdhënës për lëndët:** Hyrje në shkencat e letërsisë (sem. I); Teori e letërsisë (sem. II); Letërsi për fëmijë (sem. II); Letërsi popullore (sem. I); Folklori arbëresh (sem. IV), dhe Kritikë letrare (sem. V, programi i Gjuhës shqipe).
5. **Një mësimdhënës për lëndët:** Shkrimi në anglisht (sem. I); Shkathësitë e studimit dhe të hulumtimit (sem. II); Metodot hulumtuese në TEFL (sem. V); Metodologjia me punë praktike I, II (sem. VI-VII), dhe Hyrje në hulumtimin shkencor (sem. VIII, programi i Gjuhës angleze).
6. **Një mësimdhënës për lëndët:** Fonetikë dhe fonologji (sem. I); Anglishtja për qëllime akademike (sem. IV); Morfologji (sem. IV); Kurs i avancuar i gjuhës angleze (sem. V); Sociolinguistika dhe edukimi (sem. VI), dhe Përkthim anglisht-shqip dhe shqip-anglisht (sem. VI-VII).
7. **Një asistent** për grup lëndësh nga letërsia angleze.
8. **Një lektor për gjuhë gjermane:** Praktikë gjuhe I –VI (sem. I - VI).
9. **Një mësimdhënës për lëndët:** Hyrje në gjuhën gjermane (sem. I); Leksikologji (sem. VI); Morfologji dhe Sintaksë (sem. III-IV).
10. **Një mësimdhënës për lëndët:** Hyrje në letërsinë gjermane (sem. I); Civilizim dhe kulturë gjermane I, II (sem. I-II); Shkrim kreativ (sem. III), dhe Seminar në shkencën e letërsisë (programi i Gjuhës gjermane).
11. **Një asistent** për grup lëndësh nga Gramatika e gjuhës gjermane.
12. **Një asistent** për grup lëndësh nga Letërsia gjermane.

## V. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

1. **Një mësimdhënës për lëndët:** Matematika 1 (Prog. SD dhe TIT), Matematikë diskrete (Prog. SD dhe TIT); Autentifikimi dhe Kriptografia (Prog. TIT).
2. **Një mësimdhënës për lëndët:** Media e re dhe multimedia (Prog. SD); Hyrje në web-gjuhët dhe teknologjitë (Prog. SD); Web-Dizajn (Prog. SD), dhe Përmbajtje dinamike të Web-Inxhinierisë (Prog. TIT).
3. **Një asistent për lëndët:** Sensorët dhe Interfejset (Prog. TIT), Mikrokontrollerët (Prog. TIT), Pajisjet elektronike (Prog. TIT), dhe Machine learning (Prog. SD).
4. **Një asistent për lëndët:** Media e re dhe multimedia (Prog. SD); Hyrje në web-gjuhët dhe teknologjitë (Prog. SD); Web-Dizajn (Prog. SD), Përmbajtje dinamike të web-inxhinierisë (Prog. TIT), dhe Grafika kompjuterike dhe procesimi i imazheve (Prog. SD).

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet të kenë së paku gradën doktor të shkencave (Dr. sc.) në fushën përkatëse.

Kandidatët të cilët aplikojnë për asistentë duhet të kenë të përfunduar studimet Master ose magjistraturë në fushën përkatëse dhe të jenë jo më i vjetër se 28 vjet dhe të kenë notën mesatare jo më të ulët se 8 (tetë), më saktësisht në pajtim me nenin 174, të Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t’i paraqesin këto dokumente: kërkesën me biografi (CV), kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar, **certifikatën e lindjes** si dhe dëshminë se janë shtetas të Republikës së Kosovës, ndërsa, ata të cilët janë të punësuar në Fakultet duhet ta paraqesin edhe vendimin e zgjedhjes së fundit, dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë.

Njohja e gjuhës angleze ose e ndonjë gjuhe tjetër, të huaj është përparësi për aplikantët. Kandidatët që kanë doktoruar, magjistruar ose që kanë mbaruar studimet Bachelor dhe/ose Master jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi për **nostrifikimin** e diplomës përkatëse nga MASHT, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Përparësi në pranim do kenë kandidatët me shtetësi të Kosovës, kurse të tjerët mund të kenë statusin e mësimitdhënësit të angazhuar.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetë dhe web-faqe, respektivisht deri më datë 15-08-2015, ora 16.00

Paraqitja e dokumenteve bëhet në zyrën e protokollit nr. 308 në hapësirat e Rektoratit në UPZ.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara – **të pa nostrifikuara nga MASHT**, nuk do të pranohen - nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: <http://www.uni-prizren.com>

**Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve dhe e drejta e ankesës:** Pas hartimit dhe dorëzimit të raportit nga komisioni vlerësues, raporti për secilin kandidat të paraqitur në konkurs do të publikohet në Buletinet e universitetit, i cili qëndron i publikuar në web-faqe të Universitetit në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga dita e publikimit. Buletinet do të hartohen për të gjitha pozitat dhe kandidatët e paraqitur në konkurs për secilin fakultet veç e veç.

Gjatë fazës së publikimit të raporteve të komisioneve vlerësuese në Buletine, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrorin ankesë. Gjatë shqyrtimit të raporteve, Senati i universitetit do të shqyrtojë edhe ankesat eventuale të kandidatëve, të cilët kanë parashtruar ankesë gjatë kësaj faze.

Ndaj vendimit të Senatit mund të bëhet ankesë në më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimit në dorëzim të vendimit të Senatit të UPZ-së me të cilin pala konsideron se i është mohuar e drejta për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim.



Rektori

  
Prof. Dr. Ramë Vataj